



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 907/1 Prot.

Tiranë, më 31.03.2026

**RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË
AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL PËR VITIN 2025**

Mars 2026

I. Hyrje

Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), duke pasur në vëmendje sfidat dhe angazhimin ndaj transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, ka miratuar Planin e Integritetit i cili është miratuar me Urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 2502, datë 12.12.2023 “Për miratimin e Planit të Integritetit të Autoritetit të Aviacionit Civil 2024-2026”.

Ky Plan Integriteti synon të përmirësojë dhe përditësojë të rëndësishme dhe sistematikë në disa fusha dhe drejtime të veprimtarisë së Autoritetit të Aviacionit Civil si:

- Përmirësimin dhe përditësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, duke vënë theksin tek integriteti dhe etika institucionale .
- Përmirësimi e kapaciteteve të burimeve njerëzore duke synuar staf të kualifikuar dhe të qëndrueshëm;
- Përmirësimi i standarteve të aksesit të informacionit publik, duke synuar rritjen e transparencës;
- Përmirësimin dhe përditësimin e mekanizmave, planifikues, monitorues dhe të kontrollit të brendshëm, për menaxhim me efikasitet të të ardhurave.

Plani i Integritetit parashikon 16 masa të karakterit operacional dhe të reputacionit, të cilat janë parashikuar për tu përmbushur në disa aktivitete të njëpasnjëshme, të ndarë në 5 objektiva kryesore:

- Forcimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit;
- Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore;
- Rritja e transparencës dhe përfshirjes së publikut;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Implementimi dhe zbatimi i politikave.

Këto masa janë parashikuar për tu realizuar për periudhën 2024-2026 dhe kërkojnë angazhimin e Titullarit të Institucionit, të gjitha Drejtorive të Autoritetit, Koordinatorit për të Drejtën e Informimit si dhe Grupeve të punës të ngrituara rast pas rasti, bazuar në rekomandimet përkatëse.

II. Masat dhe aktivitetet e parashikuara për zbatim për vitin 2025 dhe niveli i realizimit për secilën objektivë.

Në planin e veprimit të miratuar për zbatimin e planit të integritetit për vitet 2024 – 2026 janë përcaktuar 16 masa dhe aktivitete për tu përmbushur gjatë vitit 2025. Këto aktivitete do të monitorohen edhe gjatë vitit 2026 si aktivitete në vazhdimësi.

Masat sipas objektivave rezultojnë si më poshtë:

Objektivi 1. Forcimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit;

Objektivi 1	Masa gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve				
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përcaktuara	Realizimi në %
Forcimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit	4	4	4	0	0	100%

Ky objektiv parashikon gjithsej, 5 (katër) masa të cilat janë parashikuar për vitin 2025, dy prej të cilave është parashikuar të zbatohet edhe në vazhdimësi gjatë viteve 2025-2026.

Përkatësisht, në zbatim të këtij objektivi, Autoriteti i Aviacionit Civil:

- Ka rishikuar Rregulloren e Brendshme të Autoritetit të Aviacionit Civil, VKD nr. 2, datë 26.02.2025, në përputhje me VKM Nr. 530, datë 1.8.2024 dhe VKM Nr. 746, datë 4.12.2024.
- Ka informuar dhe ndërgjegjësuar punonjësit e AAC-së mbi mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve, rolin të njësisë përgjegjëse, si dhe mbi parashikimet e ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes ndaj hakmarrjes.
- Ka zbatuar detyrimin ligjor, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale, për të bërë transparentë raportet e mekanizmave kombëtar dhe ndërkombëtar kontrollues dhe monitorues të AAC.
- Është organizuar trajnimi bazë i të gjithë stafit të AAC, moduli “Kompetenca e Inspektorit” duke përfshirë dhe stafin e ri.

Objektivi 2. Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore

Objektivi 2	Masa gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve				
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përcaktuara	Realizimi në %
Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore	2	2	2	0	0	100%

Ky objektiv parashikon gjithsej, 1 (një) masë për vitin 2025, e cila është parashikuar të zbatohet edhe në vazhdimësi, gjatë vitit 2026.

Përkatësisht, në zbatim të këtij objekti, Autoriteti i Aviacionit Civil:

- Ka hartuar dhe implementuar planin vjetor të trajnimeve për vitin 2025, miratuar me Vendim të DE nr. 135, datë 25.11.2024 rishikuar me Vendimin e DE nr. 39, datë 14.04.2025.
- Ka plotësuar pozicioneve vakante të planifikuara për vitin 2025.

Objekti 3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Objekti 3	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve				
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduara	Realizimi në %
Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit	3	3	3	0	0	100%

Ky objektiv parashikon gjithsej, 3 (tre) masa për vitin 2025, të cilat njëkohësisht janë parashikuar të zbatohen edhe në vazhdimësi, gjatë vitit 2026.

Përkatësisht, në zbatim të këtij objekti, Autoriteti i Aviacionit Civil:

- Ka hartuar Urdhrin dhe ka përgatitur Projekt- Programin Ekonomik për vitin 2025 brenda afateve ligjore.
- Ka ndjekur me kujdes plotësimin e deklaratës nga punonjësit pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik dhe është konsultuar rregullisht me APP.
- Ka kryer studime/analiza për tregun dhe operatorët ekonomikë të fushës së shërbimeve të përgatitura, si dhe janë përmirësuar specifikimet teknike për të përfunduar shërbime të mira.

Objekti 4. Implementimi dhe zbatimi i politikave

Objekti 4	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve				
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduara	Realizimi në %

Implementimi dhe zbatimi i politikave	4	4	4	0	0	100%
---------------------------------------	---	---	---	---	---	------

Ky objektiv parashikon gjithsej, 4 (tre) masa për vitin 2025, të cilat njëkohësisht janë parashikuar të zbatohen edhe në vazhdimësi, gjatë vitit 2026.

Përkatësisht, në zbatim të këtij objekti, Autoriteti i Aviacionit Civil:

- Ka përditësuar arkivën së akteve ligjore për punonjësit, si dhe dhe e ka publikuar atë në WEB.
- Ka amenduar procedurat e cilesise, duke shmangur mundësinë për konfuzion me versionet e fundit që duhet të përdori stafi i AAC për detyrat e përditshme, duke shmangur mundësinë për mos arritjen e afateve ose përdorimin e gabuar të formave dhe procedurave. Në këtë kontekst janë amenduar procedurat/manualet/GM si më poshtë:
 - ACAA-DAD-AIM Aerodrome Inspection Manual
 - ACAA-DAD-GM8-CA Guidance Material for the Certification of Aerodromes in Republic of Albania
 - ACAA-DAD-GM9-SRISP Guidance Material on Safety Risks for Installing Solar Panels on and near Airports
 - ACAA-DAN-CHMP Change Management Procedure
 - ACAA-DAN-PBNS Albania PBN Implementation Strategy
 - ACAA-DAN-eTOD Plani Kombëtar për Ofrimin e të Dhënave Elektronike për Terrenin dhe Pengesat
 - ACAA-DAS-ISAM Manual për Inspektorin e Sigurisë në Aviacion
 - ACAA-DAS-GM2-SZF Manual Udhëzues për Sigurinë e Zinxhirit të Furnizimeve
 - ACAA-DAS-GM5-SMAP Guidance Material for Security Measures on Airport Perimeter Protection
 - ACAA-DAS-GM7-PJPS Material Udhëzues për Implementimin e Masave të Sigurisë për Personat jo Pasagjerë dhe Sendet e Tyre
 - ACAA-DAS-GM8-IMSPBK Material Udhëzues për Implementimin e Masave të Sigurisë për Pasagjerët dhe Bagazhet e Kabinës
 - ACAA-DAS-RRSP Procedurë për Regjistrimin e Riskut dhe Shpërndarjes
 - ACAA-DER-TDPP Procedura për trajtimin e të drejtave të pasagjerëve
 - ACAA-DER-LOTAP Procedura për Licencën e Operimit të Transportuesit Ajror
 - ACAA-DFS-UASM Unmanned Aircraft Systems Manual
 - ACAA-DFS-GM11-CofR Guidance Material on Aircraft's Certificate of (de)Registration
 - ACAA-DFS-GM12-CERTF Guidance Material on Aircraft's Certificate Issuance
 - ACAA-DFS-GM13-AMO Guidance Material on Part-145 Maintenance Organisation Approval / Acceptance
 - ACAA-DFS-GM14-CAMO Guidance Materail on CAMO Organisation Approval/Acceptance
 - ACAA-DFS-GM15-UASID Udhëzues mbi Hapat për Regjistrimin e Operatorëve të dronëve në Shqipëri
 - ACAA-DTL-TRNM Training Manual
 - ACAA-DTL-LABP Language Proficiency Assessment Bodies and

- Assessment Methods Procedure
- ACAA-DTL-PLPAP Pilots Language Proficiency Assessment Procedure
- ACAA-DTL-RPCP Remote Pilot ID Certificate Procedure
- ACAA-DTL-KIPP Procedura për lëshimin e kategorizimeve për pilotë të paragrajdit/deltaplanit
- ACAA-DTL-GECP Procedure for Granting Examination Credits For Part -66 Licences
- ACAA-DTL-GM9-RPT Manual Udhëzues për Trajnimin e Kandidatëve për Patentën e Pilotit në Distançë
- ACAA-DTL-GM10-OJT66 Guidance Material for OJT for the First Type Rating in any Category or Subcategory of a Part-66 Aircraft Maintenance Licence
- ACAA-DTL-GM12-AME Guidance Material for Authorized Medical Examiners (AME).
- Ka hartuar dhe implementuar programin auditimi vjetor.
- Janë monitoruar proceset e procedurave/manualeve nëpërmjet auditit të SQSC.

Objektivi 5. Rritja e transparencës dhe përfshirjes së publikut.

Objektivi 5	Masat dhe Aktivitetet gjithsej	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve				
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduara	Realizimi në %
Rritja e transparencës dhe përfshirjes së publikut	3	3	3	0	0	100%

Ky objektivi parashikon gjithsej, 3 (tre) masa për vitin 2025, të cilat njëkohësisht janë parashikuar të zbatohen edhe në vazhdimësi, gjatë vitit 2026.

Përkatësisht, në zbatim të këtij objektivi, Autoriteti i Aviacionit Civil:

- Ka publikuar vazhdimisht informacionin zyrtar, sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit.
- Ka përditësuar rregullisht Programin e Transparencës.
- Ka kryer në çdo rast procesin e konsultimit me palët e interesuara për çdo akt nënligjor të hartuar dhe propozuar nga AAC.

III. Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të raportuara

Për vitin 2025 sipas planit të veprimit kanë qenë parashikuar 16 masa për t'u përmbushur brenda afatit, të cilat për nga niveli i rrishtit janë kualifikuar 14 në nivel mesatar, 1 nivel i lartë dhe 1 nivel i ulët.

Shkalla e realizueshmërisë së tyre është si më poshtë:

- 16 (tetëmbëdhjetë) janë realizuar plotësisht;
- 0 (zero) janë në proces realizimi;
- 0 (zero) të parealizuara.

IV. Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të planit të integritetit dhe hartimit të raportit të monitorimit.

Bazuar në të dhënat dhe gjetjet e monitorimit për këtë periudhë, rezulton se:

- AAC është angazhuar maksimalisht në zbatimin në vijimësi të Planit të Integritetit dhe përmbushjen e masave të parashikuara në planin e veprimit;
- Në kuadër të zhvillimit të burimeve njerëzore, janë kryer trajnimet e parashikuara për këtë periudhë, duke bërë të mundur rritjen e kapaciteteve si dhe ruajtjen e kompetencës së institucionit.
- Janë ndërmarrë hapa konkret në rritjen e transparencës, nëpërmjet publikimit të akteve/manualëve, raporteve në faqen zyrtare të institucionit për çdo palë të interesuar.

Rekomandohet:

- Të vijohet me zbatimin e planit të masave sipas afateve të përcaktuara;
- Të rishikohet plani i masave në përshtatje me ndryshimet ligjore dhe nënligjore në fushën e AAC;
- Të vijojë bashkëpunimi mes strukturave përgjegjëse për përmbushjen e masave;
- Të vijohet me ngritjen e grupeve të posaçme të punës, dhe koordinimit më qëllim shfrytëzimin e të gjithë afateve kohore të përcaktuara për përmbushjen e masave.

MIRATOHET
DREJTOR EKZEKUTIV
MAKSIM ET'HEMAJ

